



# **Analizë Kritike e Diskursit (De-) Konstruktimi i Diskursit të EULEX-it**

**Violeta FERATI**

**Prishtinë, Shtator 2012**

## © Të drejtat autoriale

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet ose të ndryshohet pa lejen paraprake të botuesit. Opinionet e shprehura në publikime të shkruara apo elektronike janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të partnerëve të QKSS.

Ky është studimi i pari QKSS i bazuar tërësisht në analizën e diskursit. Verzioni origjinal i shkruar i këtij hulumtimi është në gjuhën angleze kurse është përkthyer në gjuhën shqipe. QKSS dhe autori<sup>1</sup> shprehin mirënjohje për mbështetjen e Fondacionit të Shoqërisë së Hapur - Fondit 'Think Tank,' që kanë bërë të mundur hulumtimin dhe publikimin e këtij studimi. Përveç kësaj, duhet theksuar mbështetjen e përgjithshëm institucionale të Fondit 'Think Tank' në ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive të hulumtuesve të QKSS.

**Edituar nga: Florian QEHAJA dhe Pëllumb KALLABA**

---

<sup>1</sup> Violeta Ferati ka diplomuar në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Fulda – Gjermani, në Programin Master të Komunikimit Ndërkulturor dhe Studime të Bashkimit Evropian. Studimet Baçelor i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës në Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Ndër tjerash, ka qenë mësimdhënëse dhe asistente ligjëruese. Së fundmi, është emëruar Drejtoreshë Ekzekutive në Caritas Kosova. Në kuadër të Programit të OSI Think Tank Internship, ajo ka punuar në QKSS gjatë gjysmës se parë të vitit 2012.

# Përmbajtja

<b>LISTA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>4</b>
<b>HYRJA .....</b>	<b>5</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>7</b>
<b>ANALIZA KRITIKE E DISKURIT NË PRAKTIKË.....</b>	<b>9</b>
<b>1. ANALIZA KRITIKE E DISKURIT (AKD) .....</b>	<b>9</b>
<b>2. KOMUNIKIMI I (BE) -EULEX.....</b>	<b>10</b>
<b>3. DIVERSITETI I GRUPEVE TË SYNUARA NGA KOMUNIKIMI I EULEX-IT .....</b>	<b>11</b>
<b>4. EULEX-I NË KONTEKSTIN E BE-SË.....</b>	<b>12</b>
<b>5. DISKURSI I EULEX-IT NË KONTEKSTIN E KOSOVËS.....</b>	<b>14</b>
<b>KONKLuzionet .....</b>	<b>19</b>
<b>BIBLIOGRAFIA .....</b>	<b>21</b>

# Lista e Shkurtesave

---

<b>AKD</b>	Analiza e Kritike e Diskursit
<b>EULEX</b>	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit
<b>GJK</b>	Gjuhësia Kritike
<b>IPVQ</b>	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
<b>KP</b>	Policia e Kosovës
<b>MIK</b>	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
<b>PPSM</b>	Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes
<b>PSBE</b>	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
<b>QK</b>	Qeveria e Kosovës
<b>ZSHIP</b>	Zyra për Shtyp dhe Informacion Publik

# Hyrja

---

Që prej mandatit të tij zyrtar me 4 shkurt 2008, ku operacionalitetin e plotë e ka arritur me 9 Dhjetor 2008, EULEX-i është përpjekur për të krijuar dhe pastaj përmirësuar imazhin e tij duke marrë parasysh kompleksitetin e situatës politike në kohën e vendosjes për shkak të qëndrimeve kundërbënëse në skenën ndërkombëtare, d.m.th. të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Bashkimit Evropian (BE), se a kemi të bëjmë me misionin më i madh civil të BE-së nën ombrellën e Politikave të Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM). Përcaktimi i rolit të EULEX-it është një proces i vazhdueshëm që mund të evidentohet në diskursin e tij. Paqartësia e mandatit është paraqitur në shumë forma e në sfida operationale në terren, duke ndikuar kështu raportin e tij me akterët vendorë dhe ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë. Prandaj, zbulimin i marrëdhënies së padukshme në mes të EULEX-it kundrejt institucioneve kosovare përbën objektivin e këtij hulumtimi. Paqartësia e mandatit të EULEX-it në një kontekst të diskutueshëm<sup>2</sup> dhe të politizuar kishte pasoja në perceptimin e rolit të EULEX-it dhe përgjegjësitë e tij brenda një sistemi kompleks qeverisës në Kosovë, gjë që nuk ishte vetëm e paqartë për opinionin e gjerë, por edhe për vet stafin e tij.

Ky hulumtim ka gjetjet kryesore si më poshtë:

- Nocionet BE-EULEX dhe BE-Evropian(e) janë përdorur si sinonime sikurse janë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën;
- Për shkak të diversitetit të audiencës, 'standardet e dyfishta' zbatohen nga EULEX-i, gjë që reflektohet në diskursin e tyre në përdorimin e emërtimeve të dyfishta (p.sh. Prishtinë /Pristina, Kufi/Kufi administrativ), ose përdorimi i emërtimeve për institucionet e Kosovës sipas përcaktimit të UNMIK-ut (p.sh. IPVQ), ose në disa raste janë përdorë edhe emërtime të plota shtetërore (p.sh. Ministria e Drejtësisë);
- Legjitimiteti i misionit sigurohet duke iu referuar BE-së dhe shteteve të saja anëtare, vlerave të BE-së /praktikave më të mira si dhe standardeve ndërkombëtare, ku anëtarësimi në BE përdoret si një instrument stimulus;
- Dualizmat në diskurs pasqyrohen në adresimin e komunitetit shqiptar (në mbështetje të Republikës së Kosovës) dhe të komunitetit serb (politikë neutrale ndaj statusit), gjë që çon në argumentim mbrojtës në diskurs duke ri-shpjeguar mandatin e tij;
- Edhe pse pretendon që misionin e tij ka një natyrë teknike, EULEX-i paradoksalisht sinjalizon audiencën që ai po luan një rol vendimtar në çështjet politike (liberalizimi i vizave, dialogu, marrëveshja për kufi);
- Fillimisht EULEX-i ka aplikuar një qasje "lartë-poshtë" (top-down) ndaj institucioneve të Kosovës duke quajtur veten dhe ekipet e tyre si ekspertë, megjithatë, gradualisht një ndryshim është evidentuar. Në ndërkohë është identifikuar aplikimi i një qasjeje më egalitare (e barabartë), duke qenë në përkrahje të kolegëve të tyre kosovarë, të cilët mendohet të jenë bartës të drejtimit të proceseve të zhvillimit dhe duke u përkujdesur pronësinë vendore të tyre, ku fjalët që në përmbytje kanë bashkëpunimin janë përdorur gjerësisht në diskursin e EULEX-it;

---

<sup>2</sup> Për më shumë detaje ju lutemi gjeni artikullin e mëposhtëm lidhur me situatën politike gjatë vendosjes së EULEX-it: "Misioni i Bashkimit Evropian i Sundimit të Ligjit në Kosovë (EULEX) nga këndvështrimi i së drejtës kushtetuese të Kosovës" [http://www.zaoerv.de/70\\_2010/70\\_2010\\_2\\_a\\_357\\_380.pdf](http://www.zaoerv.de/70_2010/70_2010_2_a_357_380.pdf)


- Shumë-etniciteti është fjalë mjaft e përsëritur në diskursin e EULEX-it, sidomos në adresimin ose tentativës për të përfshirë 'jo-shumicën'; megjithatë, në disa raste fjala etnicitet është theksuar veçanërisht në kombinim me institucionet e Kosovës (p.sh. në polici serb i Kosovës), ose filtruar qëllimisht në lidhje me raste të dhunës (në veri);
- Dialogu Prishtinë-Beograd dhe çështja e veriut sinjalizojnë rëndësinë vendimtare (politike) në diskursin e EULEX-it, megjithatë EULEX-i përpiqet ta ruaj neutralitetin e tij dhe të shfaq një prani/rol me të madh në këto çështje, pavarësisht natyrës teknike të misionit;
- Përfundimi i mandatit të tij është shfaqur së voni më shpesh në diskursin e EULEX-it, por thuhet se ende duhet arritur "gjendja e dëshiruar përfundimtare," e cila përjashton mundësinë e tërheqjes në një të ardhme të afërt. Në ndërkohë, mandati i tij është shqyrtuar tashmë;
- Ndasitë politike (brenda BE-së) detyrojnë EULEX-in të veprojë në emërues minimal të përbashkët, kështu që qëllimisht nënvlerësohen veprimet e tij dhe implikimet politike që burojnë nga ato, gjë që në anën e tjetër ndikon në imazhin e EULEX-it;

Në vijim, ky hulumtim do t'i ofrojë lexuesit një shpjegim mbi metodologjinë e aplikuar në hulumtim dhe të dhënat që kanë shërbyer si bazë e kërkimit mbi diskursin e EULEX-it. Pjesa vijuese ofron një pasqyrë mbi teorinë e Analizës Kritike të Diskursit (AKD). Pastaj, teoria e përshkruar zbatohet konkretisht në diskursin EULEX-it. Komunikimi EULEX-it si dhe BE-së trajtohet shkurtimisht, e cila më pas në detaje shtjellon diversitetin e komunikimit të EULEX-it me bashkësitë dhe grupet përkatëse në kontekstin e Kosovës dhe se si kjo evidentohet në diskursin e tij të shkruar.

# Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim rrjedh nga një model akademik i cili është i përkufizuar dhe shpjeguar, e që bazohet kryesisht në modelin e Teun Van Dijk e njohur si qasja socio-konjiktive<sup>3</sup> me një fokus të përbërë nga elemente të diskursit, perceptimit dhe shoqërisë që shërbejnë si mjet për krijimin e fenomeneve të realitetit shoqëror. Në këtë kontekst, diskursi mund të kuptohet si një eveniment komunikativ ku përfaqësimet<sup>4</sup> sociale kanë një rol vendimtar.

Ky hulumtim ka për qëllim të përqendrohet në analizën e diskursit kritik për të evidentuar tendencat e 'gjuhës së vënë në funksion' të EULEX-it bazuar në hulumtimin e teksteve. Poashtu, fokusi është vënë në frekuencën e terminologjisë së përdorur në Raportet e Programit të EULEX-it, temat e trajtuara në njoftimet për shtyp, sidomos në nivel mikro të gjuhës së shkruar dhe stilit të shkrimit. Siç është cekur më lartë, të dhënat për hulumtimin përbëhen nga burime të ndryshme informuese të vëna në dispozicion nga EULEX-i<sup>5</sup> (shih ilustrimin më poshtë).



<sup>3</sup> Van Dijk e përcakton socio-konjiktizmin si "sistem të përfaqësimeve mendore dhe proceseve të anëtarëve të grupit." Këto përfaqësime mendore apo modelet që kanë kontrollin mbi veprimet e njerëve, të folurit apo të shkruarit dhe të kuptuarit të praktikave shoqërore të njerëzve të tjerë. Këto manifestohen zakonisht duke paraqitur veten tonë në një pozicion më pozitiv kundrejt tyre, ndërsa grupin tjetër në një perspektivë negative (Sheyholislami 2001: 3)

<sup>4</sup> Këto përfaqësime sociale të cilat mund të definojnë si "korniza kolektive të perceptimeve" shërbejnë si një urë në mes sistemit të shoqërisë dhe sistemit konjiktiv të individëve. Me fjalë të tjera, përfaqësimet sociale dhe idetë e përbashkëta (ideologjia), të cilat ndikojnë mbi njohjen e veprimit/ndërveprimit dhe janë të ndërtuara, subjekt i ndryshimeve dhe ruajnë varshmërinë reciproke (Wodak et al 2008: 25-6). Nga perspektiva e konstruktivizmit, realiteti krijohet përmes komunikimit dhe praktikës së zbatuar nga aktorët ndërkombëtarë dhe politikës së jashtme të BE-së. Prandaj, teoria e diskursit shërben për të shqyrtuar 'krijimin diskutiv të të kuptuarit e botës materiale'; mirëpo diskursi është: 'jo vetëm një mori e strukturuar e kuptimeve të ndërtuara, por edhe si proces i ndërtimit të kuptimeve.' (Tomiç 2011: 5/9').

<sup>5</sup> Intervistat janë përjashtuar si burim informacioni pasi që EULEX-i nuk posedon një arkiv të intervistave të transkriptuara.

<sup>6</sup> EULEX-i ka arritur operacionalitetin e tij të plotë në dhjetor të vitit 2008, edhe pse mandati i është miratuar në shkurt të vitit 2008. Prandaj, të dhënat për këtë hulumtojnë datojnë duke filluar vetëm nga viti 2009 dhe deri më sot (2012).

Megjithatë, në aspektin gjuhësor dhe socio-kulturor shtrohet dilema nëse analiza e të dhënave, të cilat janë të shkruara në gjuhën angleze (gjuhë burimore), përcjell mesazhin e njëjtë në versionet e përkthyer të njoftimeve për shtyp, raporteve të programit, dhe reklamat. I gjithë materiali përkthehet nga EULEX-i në gjuhët zyrtare të Kosovës (shqip dhe serbisht). Ky aspekt nuk është objekt i këtij hulumtimi, mirëpo mund të shërbejë si një impuls për kërkime të mëtejshme. Për analiza të ardhshme në fushën e AKD-së, mund të jetë interesante që të reflektohet në rast se paraqitet një ndryshim në perceptim kur krahasojmë të dhënat e përkthyer nga gjuha burimore (anglisht) në gjuhë tjera, në këtë rast në gjuhët shqipe dhe serbe, duke përfshirë edhe implikimet tentative kulturore.

Për më tepër, ky hulumtim mund të shërbejë si një burim i besueshëm për hartuesit e politikave, studentët, studiuesit, gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile që synojnë studimin më të hollësishëm të diskursit të Misionit të EULEX-it në Kosovë ose 'akter-itetit' të EULEX-it. Të dhënat janë mbledhur në mënyrë të pavarur dhe nga një perspektivë jo-anuese. Kështu që, diskursi i analizuar në këtë hulumtim është një reflektim i shpeshtësisë së deklaratave që janë transmetuar nga EULEX-i dhe një përpjekje për të zbuluar qëllimet në diskursin e tyre. Si i tillë, katër vit pas vendosjes së tij, ky është hulumtimi i parë mbi diskursin lidhur me EULEX-in, me të cilën QKSS ka për qëllim të nxisë një debat mbi rolin e EULEX-it, duke përfshirë raportin e tij ndaj akterëve vendor.



# Analiza Kritike e Diskursit në Praktikë

---

## 1. ANALIZA KRITIKE E DISKURISIT (AKD)

Për t'i ofruar lexuesit një përmbledhje të AKD-s, mbi të gjitha, fillimisht duhet përgjigjur pyetjes se "Çfarë është analiza kritike e diskursit?" Duhet të theksohet se Analiza Kritike e Diskursit është përdorur si sinonim me Gjuhësinë Kritike (GJK). Teoria<sup>7</sup> e AKD-s buron nga teori të ndryshme si retorika, gjuhësia e tekstit, antropologjia, filozofia, socio-psikologjia, shkencë konjiktive, studime letrare dhe socio-linguistika, si dhe gjuhësia e aplikuar dhe pragmatizmi (Wodak et al 2008: 1). AKD është komplekse dhe sfiduese, ndërsa kërkon një qasje multidisiplinare, multi-metodologjike nga të cilat lidhja e padukshme në mes të fjalës, konjigzmit social, pushtetit, shoqërisë dhe kulturës zbulohet, duke shkuar përtej vëzhgimit të thjeshtë, përshkrimit dhe shpjegimit (Fairclough në Van Dijk, 1993: 5). Për shkak të heterogjenitetit të madh të qasjeve teorike dhe metodologjike, praktikuesit kryesorë të AKD-s sugjerojnë ta definojnë AKD-në atë si një "shkollë" ose "paradigmë" (Wodak et al 2008: 5).

*Përkufizimi më i gjerë dhe i pranuar përgjithësisht nga studiuesit e AKD është:*

*"AKD konsideron diskursin si - përdorimi i gjuhës se folur dhe të shkruar - si një formë e 'praktikës sociale'. Përshkruan diskursin si praktikë sociale, nënkupton një marrëdhënie dialektike mes një evenimenti të veçantë diskursiv dhe situatave, institucioneve dhe strukturave sociale, që e përkufizojnë atë si:*

...

*Evenimenti diskursiv është formuar nga ato, por edhe i formëson ato. Kjo nënkupton, diskursi ndërtohet nga shoqëria, si dhe i kushtëzuar nga ajo – e që përbën situata, objekte të dijes, dhe identitetet sociale të dhe marrëdhëniet mes njerëzve dhe grupeve e njerëzore (Fairclough dhe Wodak, 1997 në Wodak et al 2008: 5.).*

Kështu, AKD konsideron diskursin si një instrument për të strukturuar jetën shoqërore. Ajo shqyrton strukturat e dukshme dhe të padukshme të marrëdhënieve të mbizotërimit, diskriminimit, pushtetit dhe kontrollit që shfaqen në diskurs, me synim të shqyrtimit kritik të strukturimit social të shfaqur në përdorimin e gjuhës<sup>8</sup> (Wodak et al 2008: 10). Përveç kësaj, Fairclough (1993) përshkruan AKD si një hulumtim sistematik të "marrëdhënieve të padukshme të shkakut dhe përcaktimit në mes të a.) praktikave diskursive, ngjarjet dhe tekstet, dhe b.) strukturave më të gjera shoqërore dhe kulturore, marrëdhëniet dhe proceset, për të hetuar se si praktikat e tilla, ngjarjet dhe tekste shfaqen dhe janë formuar ideologjikisht nga marrëdhënia e

---

<sup>7</sup> Bretherton/Vogeler: aftësia për të vepruar, ose akteri-teti, është një funksion I të dyjave: mundësive të jashtme, që përfshijnë ato që lidhen me kornizën legale ndërkombëtare dhe institucionale; dhe aftësive të brendshme, të cilat përfshijnë disponueshmërinë e instrumenteve të politikave dhe kapacitetin dhe legjitimitetin e proceseve të vendimmarrjes.

<sup>8</sup> "Teoritë e diskursit synojnë konceptimin e diskursit si një fenomen social dhe përpjekjen për të shpjeguar zanafillën dhe strukturën e vet" (Wodak 2008: 24)

pushtetit<sup>9</sup> dhe luftën për pushtet për të eksploruar ... padukshmërinë e këtyre marrëdhënieve në mes të diskursit dhe shoqërisë."

## 2. KOMUNIKIMI I (BE) -EULEX

Gjuha, përveç të qenit një mjet i komunikimit, ka edhe funksione tjera. Si një 'praktikë sociale, ajo përfshinë ideologjinë dhe aspektin e pushtetit (ndikimit) që reflekton marrëdhëniet midis njerëzve të cilat janë shpesh të padukshme. Veçanërisht nëpërmjet përdorimit të metodologjisë së AKD-s qëllimi i këtij hulumtimi është të kuptoj marrëdhëniet në mes të EULEX-it dhe institucioneve të Kosovës apo akterëve në Kosovë.

Së pari, për shkak të transformimeve nga Traktati i Lisbonës, BE-ja synon që të flas me 'një zë', duke komunikuar vetë-imazhi e saj të njohur gjerësisht që "shumëllojshmëria është patentë e BE-së" e cila në fakt jetësohet nëpërmjet funksionimit të BE-së (Rasmusen 2009: 13). Veçanërisht, karakteristika e EULEX-it si misioni më i madh civil deri më tani nën ombrellën e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM) i ka dhënë një rast BE-së për të konsoliduar 'akter-itetin' e saj në skenën ndërkombëtare, e cila ndikon në perceptimin e politikës së jashtme të BE-së nga të tjerët (Peters 2010: 17). Në mënyrë që të jemi më efikas dhe t'i drejtohem audiencës së synuar, mesazhi i transmetuar duhet përshtatur nevojave të tyre, siç definohet nga Malone (në Rasmussen 2009: 10): "Nëse ne përqijemi të jemi të suksesshëm në përpjekjet tona për të ndërtuar mirëkuptimin mbi shoqërinë tonë dhe politikën tona, duhet që së pari të kuptojmë motivet, kulturën, historinë dhe psikologjinë e njerëzve me të cilët ne dëshirojmë të komunikojmë." Deri në një masë të caktuar procesi komunikues duhet të rrjedh në drejtim të dyanshëm në formë të një dialogu, vazhdimisht duke iu përgjigjur zhvillimeve, gjë që kërkon fleksibilitet.

Sipas shoqërisë civile në Kosovë<sup>10</sup>, EULEX-i nuk ka gëzuar mbështetje të mjaftueshme nga qytetarët e Kosovës, prandaj është e nevojshme që të fitohet 'besimi publik,' gjë që mbetet një sfidë kyçe për EULEX-in. Megjithatë, është argumentuar se ky i fundit nuk ka arritur të përmbushë pritjet e qytetarëve të cilët si rrjedhojë janë shëndrruar në mosbesim për shkak të mandatit të padefinuar të misionit dhe moszbatimit të sundimit të ligjit deri më tani. Duhet theksuar se diskursi i EULEX-it karakterizohet nga një kompleksitet i bashkëbiseduesve që marrin pjesë në procesin e komunikimit. Nga njëra anë kemi akterë përgjegjës për komunikim e që janë: Zëdhënësi i Përfaqësuesit të Lartë dhe Zyrës për Shtyp e Informacion Publik (ZSHIP), të vendosura në Prishtinë. Megjithatë, ZSHIP është vetë përgjegjës për komunikimin me publikun e Kosovës, duke ndjekur moton 'informacioni vendor për konsum vendor.' Konkretisht, ajo mirëmban faqen e internetit, organizon ngjarje dhe takime me shoqërinë civile, dhe prodhon

---

<sup>9</sup> Analistët e diskursit kritik do të miratonin mendimin e Habermas-it se "gjuha është gjithashtu një instrument i dominimit dhe forcës sociale. Ajo shërben për të legjitimuar marrëdhëniet e pushtetit të organizuar. Aq sa legjitimitet e marrëdhënieve të pushtetit ... nuk janë të artikuluar ... gjuha është edhe ideologjike"(Habermas, 1967 në: Wodak, 2008: 10)

<sup>10</sup> Fuqia (pushteti) dhe Ideologjia janë konceptet qendrore për AKD:

a) Koncepti i pushtetit nënkuptohet: që një individ në një marrëdhënie shoqërore mund të arrijë dëshirën e tij apo të saj edhe kundër rezistencës së të tjerëve (Weber 1980 në: Wodak 2008: 9).

b) Ideologjia janë përfaqësimet e aspekteve të botëkuptimit të cilat kontribuojnë në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të pushtetit, të dominimit dhe shfrytëzimit. Ato mund të miratohet në mënyrat e ndërveprimit (dhe për këtë arsye në zhanre) dhe rrënjësën në të qenit identitete (dhe për këtë arsye stilet). Analiza e teksteve ... është një aspekt i rëndësishëm i analizave ideologjike dhe kritikave ... (FAIRCLOUGH, 2003 në Wodak et al 2008: 9.)

lajme për shtyp dhe reklama televizive. Kjo është hera e parë që reklama televizive<sup>11</sup> janë prodhuar për operacionet e PPSM. Deri më tani, ka pasur disa prodhime, megjithëse këto janë konsideruar të kenë pasur mungesë të kreativitetit, e që thuhet të jene prodhuar vet nga EULEX-i "... tonaliteti i tyre i thatë thekson aspektin jotërheqës, jo emocional dhe teknike të imazhit të BE-së. Dyshohet nëse cilësia e dobët mund të stimulojë përpjekjet për të fituar mbështetje në Kosovë për funksionimin e EULEX-it "(Peters 2010: 17-19). Fushata e fundit me moton: "EULEX-i nuk bën asgjë në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë", përveç fushatës televizive, përfshin fletushka (35.000), bluza dhe freskues ajri të makinave me qëllim për të sinjalizuar se lufta kundër korrupsionit është një proces i përhershëm dhe se ajo është çështje që i takon të gjithëve.<sup>12</sup> Përveç akterëve që janë përgjegjës për komunikim, nga ana tjetër kemi edhe grupin e synuar drejt të cilit komunikimi i EULEX-it është drejtuar dhe i cili do të shtjellohet në pjesën vijuese.

### 3. DIVERSITETI I GRUPEVE TË SYNUARA NGA KOMUNIKIMI I EULEX-IT

Të dy akterët e lartpërmendura të BE-së të përfshirë në komunikim synojnë një audiencë që mund të dallohet dukshëm nga publiku i BE-së, shqiptarët e Kosovës si dhe komunitetit serb që jeton në Kosovë dhe Serbi. Prandaj, diskursi i drejtuar këtyre grupeve dukshëm dallon si pasojë e pikëpamjeve të tyre krejtësisht të ndryshme lidhur me funksionimin e EULEX-it.<sup>13</sup> Megjithatë, ajo duhet të theksohet se në përgjithësi, qëllimi kryesor i BE-së nëpërmjet strategjisë së saj të komunikimit është që të forcojë imazhin e saj të politikës së jashtme të BE-së apo të qenurit aktor i rëndësishëm.

Siç thuhet në raportet e tyre të programeve, misioni i EULEX-it synon të mbështesë "rregullimin" e Kosovës drejt një "gjendje të dëshirueshme" (Raporti i EULEX Programi i 2010: 6; 2009:7;) që karakterizohet nga qëndrueshmëria, llogaridhënia, shumë-etniciteti, mos-ndërhyrja politike, përputhshmëria me standardet e njohura ndërkombëtare dhe me praktikën më të mira evropiane. Këto janë të kodifikuara si gjashtë parimet e synuara nga EULEX-i. "Gjendja e dëshirueshme" në raportin e vitit 2011 të programeve përcaktohet dhe EULEX-i i referohet si "gjendje përfundimtare."<sup>14</sup> Kështu që, këto gjashtë parime do të jenë indikatorë për të matur suksesin e EULEX-it - që mund të konsiderohet 'shtytësi' në këtë rast që ka vendosur 'rregullat.' Në fakt, thuhet se EULEX-i do të qëndrojë në Kosovë derisa gjendja e dëshirueshme është arritur, megjithatë, indikatorët kanë një natyrë cilësore dhe vështirë maten. Në raportin e saj të fundit të programeve (2012: 45), EULEX-i thekson se është e nevojshme për të krijuar një mekanizëm krahasimi në mënyrë që të vlerësojë progresin implementuesit të mandatit të tij e që do të shërbejë si një kalkulator suksezi.

---

<sup>11</sup> Për më shumë detaje ju lutem referojuni Raportit të Progresit: Made in Kosova - <http://qkss.org/new/images/content/PDF/raporti-shabllon-design-english.pdf>

<sup>12</sup> Për detaje shih artikullin: "EULEX nisi fushatën e re kundër korrupsionit" në dispozicion në: <http://www.m-magazine.org/en/Kosovo/EULEX-launched-new-campaign-against-corruption--2597>

<sup>13</sup> Megjithatë, paqartësia që përcolli vendosjen e EULEX-it dhe qasja e kompromentuar në themelimin e autoritetit të tij sollën pasoja negative në kontributin e mëtejshëm të misionit në drejtim të njohjes së tij. Kështu, siç thekson Shepherd (2009, f. 526): 'Për Prishtinën, EULEX-i është duke punuar në përputhje me mandatin e tij të marsit të vitit 2008 drejt planit të Ahtisaarit, duke respektuar Kushtetutën e Kosovës'. Në të kundërtën, 'për Beogradin, vendosja u bë e mundur nga një rikonfigurim i UNMIK-ut, që e sheh EULEX-in si neutral ndaj statusit, të vendosur nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara dhe nuk ka të drejtë zbatimin e planit të Ahtisaarit" (ibid., fq. 526-527). Kjo është një 'njohje paqartë' e misionit të EULEX-it nga ana e aktorëve të ndryshëm. Në të njëjtën kohë, kjo është faza e fundit e zbatimit të njohjes së EULEX-it nga ana e të gjithë aktorëve në Kosovë (Griçevci 2011: 11-2).

<sup>14</sup> Përkufizimi gjendjes përfundimtare (end-state): Situata e specifikuar në përfundimin e suksesshëm të fazës finale të një **operacioni ushtarak**. Tërësia e kushteve të nevojshme që përcaktojnë arritjen e **shtytësit**. <http://www.definition-of.net/end+state>

#### 4. EULEX-I NË KONTEKSTIN E BE-SË

Meqë pesë shtetet anëtare të BE-së (Spanja, Qipro, Rumania, Sllovakia dhe Greqia) nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, ekziston mospërputhje në pozicione politike kështu që është krijuar një ndarje përbrenda BE-së, e cila detyron BE-në të shpërfillë ose tejkalojë dimensionin politik në diskursin e tij rreth misionit të EULEX-it e BE-së në Kosovë. Në këtë kontekst, detyrimisht veprimi i BE-së dhe komunikimi i tij ekzekutohet në emërues minimal të përbashkëta (Peters 2010: 21). Si rezultat i kësaj, EULEX-i është paraqitur nga ana e BE-së si një "mision apolitik dhe teknik". Mesazhi apo jo-mesazhi që transmetohet është se EULEX-i nuk është i ndërlidhur me pavarësinë e Kosovës dhe se është neutral ndaj statusit dhe i shkëputur krejtësisht ndaj çdo diskursi që trajton këtë fakt. Edhe pse mediat kosovare dhe diskutimet publike intensivisht trajtojnë çështjen e statusit, EULEX detyrimisht nënvlerëson konotacionin e tij politik duke abstenuar që të marrë pjesë në ndonjë prej këtyre diskurseve. Nënvlerësimi d.m.th. të bësh qëllimisht një situatë të duket më pak e rëndësishme ose të serioze se sa që është, është një formë e ligjëratës që ri-shfaqet në diskursin e EULEX-it. Për shembull, vizita zyrtare e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së në Kosovë, përkatësisht në Veriun e Kosovës, qëllimisht u nënvlerësua në komunikimin zyrtar të EULEX-it. Në këtë kontekst, angazhimi i BE-së në Kosovë, pavarësisht politike apo teknike, thuhet të jenë aktivitete, duke minimizuar ndikimin e tyre politik [p.sh. "Ai ishte veçanërisht i interesuar për të parë aktivitete e BE-së në Mitrovicën e Veriut." Lajm për shtyp 2010, Maj]]. Në përputhje me këtë, vizita e shefit të Misionit në Beograd është po ashtu nënvlerësuar duke përdorur formulime të thjeshta si: "Në takimet e tij me ministrat çështje teknike që lidhen me sundimin e ligjit janë diskutuar" (Lajm për shtyp 2011, Qershor) në mënyrë që të minimizohet rëndësia e takimit me zyrtarë të lartë të institucioneve serbe - të cilët ishin emëruar thjesht si ministra e të shkruar me shkronja të vogla, në vend që të shkruhen me shkronja të mëdha (si emra të përveçëm).

Sa i përket zbatueshmërisë të së drejtës së Kosovës, EULEX-i nuk i përmend ndryshimet politike në 2008 edhe përkundër faktit se i referohet ligjit që u miratua në periudhën nga institucionet e pas-pavarësisë [Ilustrim: ... Ligji mbi Kodin Doganor dhe ai i Akcizës të Kosovës ka hyrë në fuqi në fund të vitit 2008. Ky Kod është në përputhje me standardet e BE-së si dhe u frymëzua nga Kodi i Bashkimit Evropian Doganor" (Raporti i programeve 2009: 16)]. Është e qartë se legjitimitimi është siguruar duke deklaruar se ligji është *në përputhje me standardet e BE-së* si dhe *u frymëzua* nga Kodi Doganor i BE-s. Siç e thekson Greiçevci (2011: 12): "Duke pasur parasysh faktin se EULEX-i duhet të zbatoj ligjet, kjo nënkupton zbatimin e ligjeve ose rregulloreve të Kosovës apo të UNMIK-ut. Kjo ka implikime politike dhe ilustron faktin se statusi i Kosovës influencon natyrën e EULEX-it dhe për këtë arsye nuk mund të pretendohet se EULEX-i është thjesht një mision teknik".

Në lidhje me mosmarrëveshjet politike të pazgjidhura, EULEX-i ka marrë parasysh çështjen aktuale mbi kufijtë e Kosovës kundrejt fqinjëve të saj, dhe prandaj ata përdorin termat "kufi" dhe "kufi administrativ" (Raporti i programeve 2011: 10) njëkohësisht për të përfshirë dy perspektivat, atë të Kosovës (që përpiket për sovranitetin territorial dhe këmbëngul në përdorimin e termit 'kufi') dhe atë të Serbisë (e cila nuk e konsiderojnë të ketë kufi me Kosovën, duke këmbëngulur në përdorimin e terminologjisë 'kufi administrativ'). Duhet theksuar se EULEX-i kur i referohet konceptit/marrëveshjes MIK (Menaxhimi i Integruar i Kufirit), në mënyrë eksplicite thotë që ajo të jetë Menaxhim i Integruar i Kufirit. Mirëpo, EULEX-i ka shpikur edhe një profil të ri të policëve të Kosovës – e që janë Policia Kufitare/e Kufirit Administrativ (?) të Kosovës (PKK), i cili në bazë të strukturës së PK-së<sup>15</sup> dhe Ligjit për Policinë është një përcaktim apo strukturë që nuk ekziston.

Sidomos nocionet - BE dhe Evropiane janë përdorur (si në këtë rast) si sinonime (shih Aneksin I) sikurse këto terma të ishin në harmoni të plotë me njëra-tjetrën. Ngjajshëm, EULEX paraqet

<sup>15</sup> Për më shumë detaje në lidhje me PK, shihni web faqën e tyre: <http://www.kosovopolice.com/?page=2,22>

vetën dhe BE-në si një tërësi [p.sh. "... Granatat u hodhën në drejtim të policëve të EULEX-it...në drejtim të policisë së Bashkimit Evropian dhe atyre të angazhuar në..." (Lajm për shtyp, prill 2009)]. Për më tepër, në një akt të dhunshëm kundër EULEX-it, në lajm për shtyp thuhet (2011, tetor) se: "Ishte një sulm kriminal kundër misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë dhe si i tillë është i papranueshme." Në këtë deklaratë me shkrim në vend të fjalës EULEX, theksi është vënë në Bashkimin Evropian, dhe gjatë leximit të tekstit jepet përshtypja se sulmi kriminal ishte kundër BE-së. Kështu që, në mënyrë indirekte mesazhi është dërguar se në rast se EULEX-i sulmohet, atëherë kjo automatikisht do të nënkuptoj sulm kundër BE-së.

Në veçanti, EULEX-i e vë theksin më shumë se "çka është" në vend se "çfarë paraqet," gjë që në perspektivën akademike quhet si 'infopolitikë evropiane' e që nënkupton se BE-ja ka për qëllim përhapjen e informacioneve të tilla. Duke pasur parasysh pluralizmin e audiencës dhe me qëllim për të arritur atë, EULEX detyrohet të deklarojë në mënyrë të përsëritur se mandati i saj "është konfirmuar në ftesën nga autoritetet e Kosovës dhe në një letër të dërguar nga Presidenti i Serbisë, Z. Tadiq, Përfaqësuesit të Lartë të BE-së, z. Solana."<sup>16</sup> E pranuar nga Kosova, Serbia dhe BE, ky fakt siguron legjitimitetin e EULEX-it për të vepruar në Kosovë (e sidomos në Veri). Burimet e fundit kanë evidentuar diskursin mbi përfshirjen e misionit të EULEX-it në Kushtetutën e Kosovës, në mënyrë që të legjitimojnë praninë e tyre edhe pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur.

Është evidentuar një tendencë në diskursin e EULEX-it për t'iu referuar standardeve të BE-s, praktikave më të mira si dhe vlerave evropiane (Lajm për shtyp 2009, shtator). Megjithatë, asnjë specifikim nuk është bërë mbi atë se çka nënkuptohet me Traktatin e Lisbonës, Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore (Lajm për shtyp 2009, dhjetor), duke nënvizuar se objektivi i tyre është: "për të promovuar stabilitet, siguri dhe prosperitet – dhe me këtë vlera evropiane," në këtë mënyrë theksohet se vlerat evropiane janë stabiliteti, siguria dhe prosperiteti (Lajm për shtyp 2010, maj). Lidhur me ndërtimin e vetë-imazhit të të qenurit akter, fillimisht në vitin 2009 (Lajm për shtyp, shtator) EULEX-i aludon të jete një institucion i BE-së, gjë që është sinjalizuar përmes kësaj deklaratë: ". ... Duke punuar ngushtë me EULEX-in dhe të tjera institucione evropiane." Ndërsa, dy vjet më vonë, EULEX-i përmend këtë në mënyrë eksplicite se "EULEX është një institucion i BE-së" (Lajm për shtyp 2011, qershor). Pra, EULEX-i synon të njihet si një institucion i BE-së, dhe ndoshta për të lidhur perspektivën e integritit të Kosovës me praninë e tij.

Vlen të theksohet që në vitin 2011 për herë të parë EULEX-i theksoi përfundimin e mandatit të tij, por kjo ende nuk ka gjasa të ndodhë për shkak të mangësive në sektorin e sundimit të ligjit [Raporti i Programeve 2011: 7 - Ilustrim: "Progresi i institucioneve dhe agjencive të sundimit të ligjit do të thotë përparim drejt përmbjlljes graduale të misionit. Nëse sot ky skenar mund të shihet vetëm "në horizont" është thjesht sepse ne nuk kemi arritur ende aty. Sistemit i sundimit të ligjit është ende në ndërtim e sipër. Jo të gjitha copat në hartë janë në vendin e tyre"]. Pavarësisht nga diskutimet e mbi përmbjlljen, në fillim të viti 2012 diskursi i EULEX-it është karakterizuar nga ristrukturimi i saj i cili u finalizua në qershor 2012. Kohët e fundit ri-ndërtimi i imazhit të EULEX-it konsiston në transformimin për tu bërë 'të fortë, më kompakt, më efikase' (Lajm për shtyp 2012, mars). Për më tepër, EULEX-i ka deklaruar se do të "luajë një rol kyç" në marrëdhënien Kosovë - BE, nëpërmjet së cilës ajo ruan dhe / ose rrit rëndësinë e saj për të qenë një aktor kyç në marrëdhënien e BE-së kundrejt Kosovës, pavarësisht se ka natyrë teknike të misionit. Nga perspektiva e EULEX-it, dialogu i strukturuar, dialogu mbi liberalizimin e vizave dhe studimi i fizibilitetit janë të lidhura me 'sundimin e ligjit' prandaj 'kontributi strategjik' i EULEX-it në këtë drejtim është i justifikuar (Raporti i Programeve 2012: 6).

<sup>16</sup> Për detaje ju lutem referojuni shtypit: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0010.php>

## 5. DISKURSI I EULEX-IT NË KONTEKSTIN E KOSOVËS

Për shkak të përvojave të mëparshme (p.sh. kompetenca ekzekutive të misionit të Kombeve të Bashkuara), shqiptarët e Kosovës presin që problemet të tyre të definohen nga bashkësia ndërkombëtare. Në këtë kontekst, EULEX-i është thënë të jetë i papërkushtuar sa duhet për integrimin e strukturave ilegale serbe në institucionet e Kosovës.<sup>17</sup> Si rezultat i kësaj, EULEX në raport me publikun kosovar (shqiptar), në mënyrë të përsëritur ka nënvizuar se misioni<sup>18</sup> i tij qëndron në mbështetjen e autoriteteve kosovare nëpërmjet metodologjisë së këshillimit, mentorimit dhe monitorimit (MMA), dhe se ka kompetenca të kufizuara ekzekutive të cilat nuk janë elaboruar në mënyrë të detajuar, por të përmendur vetëm shkurtimisht (p.sh. " [EULEX-i] gjithashtu ka zbatuar mandatin e tij ekzekutiv" Lajm për shtyp 2009, shtator). Në këtë kontekst, EULEX-i (Raporti i programeve 2012: 46) shkurtimisht përmbledh mandatin e tij ekzekutiv që përbehet nga lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe duke trajtuar në mënyrë të pavarur rastet më të ndjeshme. Roli i 'kufizuar' reflektohet në faqen e internetit të EULEX-it me parullën kryesore: "Mbështetja e pronësisë vendore" përmes të cilit ata sinjalizojnë se aktori kryesor përgjegjës është Qeveria e Kosovës. Kjo është theksuar shprehimisht edhe në parathënien e shefit të Misionit të EULEX-it që autoritetet vendore "e kanë pronësinë dhe kontrollojnë procesin" (Raporti i EULEX Programi 2010: 5). Në këtë kontekst, EULEX-i detyrohet që tua shpjegoj kosovarëve se mandati dhe funksioni i tyre është i kufizuar. Argumentimi i tyre mund të definohet si i të qenurit mbrojtës pasi që nuk përqendrohet në përparësitë (pikat e forta) të tij. Për shkak të implikimeve politike kjo është e arsyeshme, megjithatë, nga ana tjetër imazhi i EULEX-it është i ndikuar (Peters 2010: 23). Në Raportin e vitit 2012 të Programeve (45), EULEX-i për herë të parë flet për institucione 'nikoqire' të sundimit të ligjit, gjë që deri më tani nuk kanë qenë pjesë e diskursit të tij. Këtu mesazhi transmetohet se EULEX-i e konsideron veten si 'mysafir' kundrejt institucioneve kosovare, kështu që pronësia më e madhe i atribuohet vendorëve dhe përgjegjësia për progres i transferohet institucioneve vendore.

Për më tepër, një argument i fortë i EULEX-it mbetet theksimi i integritetit të Kosovës në BE që strategjikisht inkurajon reformimin e vendit dhe konformitetin ndaj standardeve të BE-së. Siç dihet, anëtarësimi në BE është konsideruar të jetë "karrota e artë" gjë që influencon reformimin politik dhe ekonomik të vendit kandidat për anëtarësim në BE (Grabbe 1999: 8). Siç u përmend më lart, EULEX i referohet vlerave të BE-së në mënyrë që të legjitimojë politikën e BE - EULEX. Është evidentuar se EULEX-i i referohet shteteve anëtare të BE-së ku në mënyrë eksplicite është përmendur mbështetja e tyre e plotë, (Lajm për shtyp 2009, shtator) në mënyrë që të rrisin legjitimitetin dhe pranimin e politikave të tyre dhe rrjedhimisht të minimizojë kundërshtimet. EULEX-i në diskursin e tij të fundit thotë se ajo do të plotësojë përkpjekjet për agjendën e BE-së në Kosovë (Raporti i Programeve 2012: 6).

Në Raportin e Programeve të tij të vitit 2010 (2010: 37), duke iu referuar Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, EULEX-i shpjegon se autoritetet publike të Kosovës<sup>19</sup> janë ose komuna ose

<sup>17</sup> Për më shumë detaje shini Raportin e QKSS "Zbatimi Politik i Ligjit në Kosovë" të disponueshëm në: [http://qkss.org/new/images/content/PDF/Zbatimi\\_politik\\_i\\_ligjit\\_ANG.pdf](http://qkss.org/new/images/content/PDF/Zbatimi_politik_i_ligjit_ANG.pdf) dhe artikullin online: <http://www.evropaelire.org/content/article/24278666.html>

<sup>18</sup> Deklarata e Misionit (Neni 2) EULEX KOSOVË do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe fuqizimin e një sistemi të pavarur shumetnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimi doganor multi-etnik, duke siguruar që këto institucione të jenë të paprekura nga ndërhyrjet politike dhe duke i respektuar standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane. EULEX KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me programet e asistencës të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke mbajtur dhe disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

<sup>19</sup> Definicioni nga i njeiti ligj: "Autoriteti Publik" - do të thotë: (i) cilido trup publik, autoritet ose agjenci që vepron në bazë të autorizimit të ligjit apo Rregullores së UNMIK-ut, ekzekutiv, legjislativ, rregullativ, administratë publike ose kompetencë gjyqësore, dhe përfshin (ii) cilindo departament apo pjesë ose nën-njësi të këtij organi ose autoriteti publik. [http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=141&Itemid=56&lang=en](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=141&Itemid=56&lang=en)

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), përkundër realitetit të ri politik në Kosovë që nga viti 2008. EULEX-i vazhdon të përdorë termin IPVQ të shpikur nga UNMIK-u edhe dy vjet pas pavarësisë, paradoksalisht duke iu referuar ligjit që u miratua nga institucioneve shtetërore (Qeveria) të pas-pavarësisë, dhe jo IPVQ siç i quan EULEX-i ato. Për më tepër, në kontrast me këtë, EULEX-i i referohet ministrive përkatëse sipas emërimit të tyre institucional (Ministria e Drejtësisë si MD, Ministria e Punëve të Brendshme - MPB, Ministria e Ekonomisë dhe Financave - MEF), por në të njëjtën kohë e bën përdorimin e terminologjisë së tejkualuar të UNMIK-ut. E njëjta gjë zbatohet për institucionet tjera të Kosovës, në të cilat raste EULEX përdor përcaktimin adekuat si Policia e Kosovës (PK - një term i cili u vënë në përdorim pas Deklaratës së Pavarësisë) (EULEX Programi Raporti 2009:12) ose Kuvendi i Kosovës (Programi i EULEX-it Raporti 2009: 151). Në këtë kontekst, termi politik 'Qeveria e Kosovës' (EULEX Programi Raporti 2009: 75) është përdorë vetëm në 6 raste, ndërsa në 27 raste vetëm termi 'qeveria' është përdorur më shkronja të vogla. Këtu nuk ka tregues të saktë se cilës qeveri i referohet dhe qëllimisht nuk i bëhet referencë statusit të Kosovës, përkatësisht Shpalljes së Pavarësisë dhe rrjedhimisht emërimit të saj si Republika e Kosovës. Megjithatë, është karakteristike se në Raportin e Programit 2011, EULEX-i për herë të parë flet për "partnerët e Kosovës" e cila shënon një ndryshim në diskursin gjë që në raporte të tjera tendencat konsistonin në përdorimin e formulimit 'homologët e Kosovës' dhe duke ruajtur kështu neutralitetin.

Ekziston një dualitet në diskursin e EULEX-it, pavarësisht nga deklaratat e tij të përsëritura që ata janë neutral ndaj statusit, në anën tjetër EULEX-i mbështet institucionet shtetërore të Kosovës në zhvillimin e tyre dhe rrugën drejt BE-së. Një frekuencë e lartë e fjalëve që paraqesin bashkëpunimin (shih Aneksin I p.sh. të përbashkët, së bashku, koordinim) janë evidentuar në diskursin e EULEX-it kundrejt institucioneve të Kosovës të cilat janë të përcaktuara si efektive, gjë që në anën tjetër rrit kredibilitetin e EULEX-it dhe pranimin e popullsisë kosovare (shqiptare). Pavarësisht faktit që EULEX nuk përmend përcaktimin politik të institucioneve shtetërore, është evidentuar vetëm një rast ku EULEX përdorë termin "Republika e Kosovës" (Lajm për shtyp 2012, prill), por kjo është deklaruar vetëm në formën e një citati, dhe si e tillë nuk është thënë drejtpërdrejt nga EULEX-i. Megjithatë, kjo mund të interpretohet si një ndryshim në diskursin, i cili mund të jetë i lidhur me ndryshimet e mundshme të ardhshme në politikën e status-neutralitetit të EULEX-it. Megjithatë së voni, EULEX në pjesën e dytë Raportit të tij të Programeve (2012: 44) për vitin 2012 flet mbi Pavarësinë, Kushtetutën, Zyrën Civile Ndërkombëtare dhe Planin e Ahtisaarit, ndërsa përshkruan gjendjen politike kur ajo ishte vendosur dhe ndryshimet që kanë ndodhur që nga atëherë. Mirëpo, EULEX në të kaluarën ka abstenuar të komentoj mbi çështjet që bartin implikime politike.

Siç tregohet në tabelë, EULEX-i gjatë këtyre viteve ka përdorur termin "ekspert" vetëm në kombinim me stafin e tij dhe burimet e veta, ndërsa asnjë kombinim i fjalës - ekspert - nuk është evidentuar me aktorët vendorë. Është evidentuar se EULEX-i përdor termin homologët (counterpart) (Raporti i Programeve 2009:9) ose adreson nivele më të ulëta kryesisht si aspekt operativ – teknik, në vend që t'i referohet institucioneve apo aktorëve, qofshin ato ndërkombëtare ose vendore. Kështu që, makro niveli dhe sidomos politika është anashkaluar qëllimisht, duke shmangur përdorimin e emërtimeve politike. Për shembull: në vend të institucioneve apo mekanizmave të vendosjes së ligjit, EULEX-i i referohet sektorit të sundimit të ligjit në përgjithësi, p.sh. "Menaxherët Kosovar të sundimit të ligjit" (2009: 9). Sot EULEX-i pretendon të jetë një komponent ekspertësh veçanërisht duke iu referuar sektorit të drejtësisë, ku EULEX-i mban rolin kryesor në këtë aspekt dhe të përqendruar mbi veten e tij flet mbi veprimet e ndërmarra. Krahasur me drejtësinë, EULEX-i paraqet ndryshe zhvillimet në lidhje me doganat dhe policinë, ku aktorët/autoritetet vendorë përbëjnë fokusin kryesor (Raporti i Programeve 2012: 22).

Diskursi i EULEX-it sidomos në vitin 2011 karakterizohet gjerësisht nga dialogu Prishtinë-Beograd. Marrëveshjet janë cilësuar si të suksesshme dhe konform vlerave evropiane, me të cilat marrëveshjet janë në harmoni [p.sh. "...marrëveshje e arritur në Dialogun lidhje .. është në përputhje me vlerat evropiane.." (Lajm për shtyp, 2011, shtator)]. Është përsëritur se BE dhe standardet/vlerat evropiane janë përdorur si sinonime sikurse të ishin po e njëjta gjë. Në të njëjtën lajm për shtyp, është përcjellë mesazhi se EULEX-i dhe Përfaqësuesi Special Evropian (PSBE) ishin pjesë e zgjidhjes së marrëveshjes ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, pasi që autoritetet e Kosovës janë konsultuar me ata. Prandaj, EULEX dhe EUSR mund të pretendojnë legjitimitetin për të udhëhequr/mbikëqyr procesin e zbatimit për të cilin ata kanë shpresuar. Tërthorazi, të dy akterët kanë mirëpritur dhe mbështetur marrëveshjen. Për më tepër, EULEX-i në vazhdimësi promovon dialogun në diskursin e tij, duke theksuar se ky është instrumenti i vetëm për të arritur një zgjidhje të mosmarrëveshjeve (Lajm për shtyp, 2011, korrik). Pas ristrukturimit të EULEX-it (qershor 2012), Veriu dhe Dialogu janë përbërës të katër objektivave kryesore operative (Raporti i EULEX Programi 2012: 46).

EULEX-i përsërit se misioni i tij është mbështetur plotësisht nga BE, duke theksuar të gjitha 27 shtetet anëtare, duke përfshirë dhe i dhënë kredi Përfaqësuesit të Lartë. Gjithashtu, EULEX ka përsëritur që ka pëlqimin e autoriteteve të Kosovës. Megjithatë, kjo në mënyrë të konsiderueshme dallon nga diskursi i vitit 2009 meqë nuk përmend miratimin e Serbisë<sup>20</sup> (shih Lajm për shtyp 2009, deklaratë qershor: "Ky mandat ka qenë i konfirmuar në ftesën nga autoritetet e Kosovës dhe në një letër të dërguar nga Presidenti i Serbisë, Z. Tadiq, për të Përfaqësuesit të Lartë të BE-së, z. Solana ").

Po ashtu, EULEX-i ka deklaruar se: "Prokurorët e Kosovës hetojnë rastet me ndihmën dhe mbështetjen e kolegëve të EULEX-it, aty ku është e nevojshme" (Lajm për shtyp, 2011, Maj). Këtu tërthorazi pronësia është transferuar tek vendorët, duke theksuar se kjo është përgjegjësi e tyre. Termi 'Ekspert i EULEX-it' nuk është përdorur si zakonisht nga EULEX-i. Në vend të kësaj ata përdorin termin egalitar (të barazisë) të kolegut. Për dallim nga diskursi i mëparshëm i EULEX-it, fokusi është vënë tani në akterët vendorë të Kosovës (prokurorët në këtë rast). Në shumicën e rasteve të tjera diskursi i tyre u përqendrua kryesisht në vet EULEX-in dhe veprimet e tyre. Duket se EULEX gradualisht po kalon në një rol plotësues, duke i dhënë hapësirë vendorëve për të vepruar. Paraqitet dilema nëse kjo mund të kuptohet që kapaciteti i akterëve të Kosovës (prokurorët) është rritur dhe se ata janë të aftë të udhëheqin proceset. Një Lajm për shtyp (2012, prill) theksoi se ekziston një ekip i përbashkët i Njësisë së Policisë së EULEX-it për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Departamenti i Krimit të Organizuar i Policisë së Kosovës, gjë që simbolizon se EULEX dhe zyrtarët e PK janë bërë të barabartë, një dukuri që nuk është tipike për diskursin e mëparshëm të EULEX-it, ku këta fundit ishin ekspertët. PK është vlerësuar të ketë përparuar shumë dhe si i tillë konsiderohet si homologe e EULEX-it (Raporti i Programeve 2012: 11).

Diskursi i EULEX-it në drejtim të serbëve dhe komunitetit serb të Kosovës karakterizohet nga argumente ku EULEX-i synon të bind këtë komunitet se punojnë në favor të interesit të tyre po ashtu. EULEX-i gjithashtu synon të arrijë tek audienca serbe (në Serbi) meqë ata ndikojnë tek serbët e Kosovës, sidomos kur kemi të bëjmë me opinionet kundërshtuese që pretendojnë se EULEX-i është duke zbatuar pavarësinë e Kosovës. Prandaj, EULEX-i është shumë i angazhuar në parandalimin e përhapjes së informacioneve të rreme në lidhje me mandatin e tij dhe rolin e tij ndaj serbëve dhe serbëve të Kosovës (Peters 2010: 25).

---

<sup>20</sup> Për shkak të refuzimit të Planit të Ahtisaarit, Serbia dhe shtetet të tjera jo-njohëse të BE kushtëzuan vendosjen e EULEX-it vetëm në bazë të Rezolutës 1244. Edhe pse parashihet me Propozimin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, EULEX-i është misioni i vetëm i CSDP që periodikisht i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së - duke e bërë rastin e Kosovës një përgjegjësi e përbashkët për të dytë OKB-në dhe BE-në. <http://qkss.org/new/images/content/PDF/English%20version%20-%20Mapping%20the%20UNSCR%201244%20legacy%20in%20post-independent%20Kosovo%20between%20contestation%20recognition.pdf>



Nëpërmjet përsëritjes së promovimit të shumë-etnicitetit në institucionet e Kosovës, EULEX-i synon të sinjalizojë se serbët e Kosovës janë të përfshirë në të ardhmen e Kosovës dhe çdo përpjekje për të përjashtuar interesat e tyre dënohet nga EULEX-i. Pasqyruar në tabelën e terminologjisë (shih Aneksin I) së përdorur më shpesh nga EULEX-i, fjala (shumë-) etnik është përsëritur mjaft shpesh. Siç u përmend me lart, diversiteti është markë e BE-së. Në përputhje me këtë, EULEX-i thekson shumë-etnicitetin e popullsisë së Kosovës duke nënvizuar konkretisht etnicitetin e komuniteteve me fjalën përcaktues "Kosovë" [p.sh. Serbë të Kosovës, turk apo boshnjak i Kosovës, (Raporti i Programeve 2009: 87)]. Përveç kësaj, duket sikur BE-EULEX kanë shpikur një term të ri, gjegjësisht 'grupe/komunitete (etnike) jo-shumicë' (Raporti i Programeve 2009:17) i cili është termi i ri-përsëritur (54 herë) për pakicat.<sup>21</sup> Duke pasur parasysh audiencën e larmishme të synuar nga diskursi i EULEX-it, kur flitet për qytete në Kosovë emërtimi i tyre është përdorur në gjuhën shqipe dhe serbe [p.sh. Prishtinë/Priština (Raporti i Programeve 2009:30)]. Megjithatë, gjatë vitit 2012 në raportin e programeve, EULEX përdor vetëm emërtimin (shqip) Prishtinë, i cili mund të sinjalizojë një ndryshim në diskursin si.

Në këtë kontekst, kur behët fjalë për ndërlidhjen e pakicave (sidomos komunitetin serb) me institucionet e Kosovës, EULEX-i qëllimisht i shmanget përdorimit të këtij kombinimi në një frazë të vetme. Në raste është përdorur "policët e etnisë serbe" (Raporti i Programeve 2009: 13) në vend të frazës policët serb të Policisë së Kosovës, dhe si e tillë nuk specifikohet që ata janë zyrtarë policorë që punojnë nën autoritetin e Kosovës. Në një rast tjetër, 'polici serb' është përdorur me termin "Kosovë:" "Polici serb i Kosovës" (Raporti i Programeve 2009: 57), megjithatë duke mos deklaruar drejtpërdrejt se ata janë policë të Policisë së Kosovës. Si rezultat i kësaj, diferencimi i oficerëve të policisë sipas përkatësisë së tyre etnike, sidomos ata serb, mund të minimizojë nivelin e tyre të integritit dhe ndoshta mund të ndikoj në diskriminim të mëtejshëm. Për më tepër, në lajmin tij për shtyp (2009, qershor), EULEX-i madje pretendon se do të "rindërtojnë një shërbim policor të vërtetë shumë-etnik", me të cilën ata mund të kenë sinjalizuar audiencën serbe (të Kosovës) se kjo është në interesin e tyre, por nga ana tjetër për publikun shqiptar kjo mund të interpretohet sikur PK nuk është përpjekur mjaftueshme për të krijuar një polici 'të vërtetë' shumë-etnike. Për befasi, vetë EULEX-i thekson në raportin e tij se PK-ja është "një organizatë shembullore e policisë," në kontekstin e Ballkanit Perëndimor dhe Evropës në tërësi, ku deri në 14% e stafit të policisë janë nga pakicat etnike të Kosovës (9% e tyre janë nga komuniteti serb).<sup>22</sup>

Përveç policisë shumë-etnike, EULEX-i ka tejpërdorur fjalën shumë-etnike dhe diskutimin lidhur me drejtësinë shumë-etnike, duke lënë përshtypjen sikur ka një diferencë midis drejtësisë dhe drejtësisë shumë-etnike, të aplikueshme vetëm në kontekstin e Kosovës (shih lajmin për shtyp 2009, dhjetor). Ngjashëm me këtë, kur flitet për komunitetin serb në Kosovë kundrejt institucioneve të Kosovës, EULEX-i nuk e përmend në mënyrë eksplicite institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë, në vend që ata theksojnë shërbimet që këto institucione ofrojnë dhe që janë në shërbim të komunitetit serb [p.sh. "... nevojat e komunitetit serb të Kosovës, duke iu siguruar atyre qasje në shërbimet e sundimit të ligjit ..." (Raporti i Programeve 2010: 65)].

Në veçanti kur trajtohet rastit i ndjeshëm i veriut, veriu i Kosovës apo të Mitrovicës, që si sinonim përdoret në lajmet e tij për shtyp, EULEX-i synon të ruajë neutralitetin e tij që pasqyrohet edhe në gjuhën e tyre. Për shembull: "EULEX-i zgjeron praninë e tij në Mitrovicë për të mbështetur policinë vendore", ku nuk përmendet qartë Policia e Kosovës, edhe pse deklarata aludon në të (Lajm për shtyp 2009, janar). Dhe kur flitet për dhunën në veri, specifikimi etnik filtrohet (p.sh. "... veprimet e dhunshme të një pakice të vogël njerëzish në veri të Kosovës ..."),

<sup>21</sup> Shiko Aneksin 1.

<sup>22</sup> Për më shumë detaje referojuni librit të QKSS (fq.82): Monitorimi dhe Vlerësimi i Qeverisjes së mire në Sektorin e Sigurisë" të disponueshëm në:  
<http://qkss.org/new/images/content/PDF/Monitoring%20and%20Evaluating%20the%20Good%20Governance%20in%20the%20OKSS.pdf>

me qëllim që të zvogëlohen asocimet negative. Nocionet politike (p.sh. qytetarët), janë anashkaluar po ashtu, në vend të kësaj përgjithësimi është përdorur, si për shembull: "Të gjithë njerëzve u kërkohet që të qëndrojnë të qetë" (Lajm për shtyp 2009, janar). Kryesisht është përdorur ligjëratat e zhdrejtë në komunikimin e EULEX-it (p.sh. dhënia e rekomandimeve apo kërkesa paraqitjen) e cila është bërë qëllimisht në mënyrë që të heq vëmendjen nga agjenti i veprimit. Veçanërisht në këtë kontekst, diskursi i EULEX-it në vitin 2009 karakterizohej nga distancimi ndaj çdo dialogu politik duke deklaruar se: "Është në dorë të palëve që ta zgjidhin këtë çështje përmes negocimit dhe dialogut" (Lajm për shtyp 2009, prill). Megjithatë, në vitet e ardhshme ky diskurs ka ndryshuar dukshëm. Megjithatë, në lajmin e tij për shtyp (2012, shkurt), në lidhje me dialogun EULEX-i ka deklaruar: "Shefi i Misionit përsëriti mbështetjen e tij të plotë në zbatimin e dialogut, duke theksuar se EULEX-i është i gatshëm të mbështesë çdo marrëveshje të arritur." Prandaj, ata do të mbështesin çdo marrëveshje, e cila gjithashtu mund të (mos) bie në kuadër të mandatit të tyre. Është kontraktive, që në vitin 2009 diskursi i tyre karakterizohej nga neutraliteti dhe mos-përfshirja sigurisht në përputhje me situatën (krahaso: "Është në dorë të palëve që ta zgjidhin këtë çështje përmes negocimit dhe dialogut" (Lajm për shtyp 2009, gusht)).

Sidomos kur bëhet fjalë për çështjen diskutabile politike në veri, diskursi i EULEX-it karakterizohet me përpjekjen për ta siguruar komunitetin serb në Kosovë dhe Serbinë që veprimi i EULEX-it është dakorduar nga autoritetet serbe në Beograd, siç është evidentuar në lajmin për shtyp (2009, qershor) "... në mënyrë të qartë është komunikuar që të gjitha ato masa në takime me Ministrin serb të Punëve të Jashtme, zyrtarët serb të taksave dhe administratës doganore dhe përfaqësues i Ministrisë për Kosovën, ku nuk kishte komente negative mbi krijimin masave të reja tek Portat 1 dhe 31....nuk janë refuzuar shkresat e dërguara nga Shefi i Doganave të EULEX-it drejtuar ministrit serb të Financave për ta informuar për masat e planifikuara." Duket sikur strategjia e EULEX-it është që të rrisë pranimin e saj nga komuniteti serb në Kosovë përmes bashkëpunimit me Beogradin. Siç ka thënë shefi i misionit (Lajm për shtyp 2010, tetor), çështja e veriut ka qenë një shqetësim për EULEX-in gjatë gjithë mandatit të tij dhe ishte prioritet në aspektin e sundimit lokal të ligjit. Në kontekstin e veriut kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht tligjin e Kosovës, meqë në Veri zbatohen kode të ndryshme ligjore të Jugosllavisë, UNMIK-ut, Serbisë dhe pjesërisht të Kosovës. Megjithatë, EULEX-i thekson në mandatin e tij të ristrukturuar që sundimi i ligjit në veri është objektivi i tij kryesor (Raporti i Programeve 2012: 45).

# Konkluzionet

---

Siç është trajtuar me lartë, paqartësitë e mandatit, që nga miratimi i tij në vitin 2008, kanë pasur implikime në vendosjen e EULEX-it në Kosovë, gjë që evidentohet në diskursin e tij. Nga njëra anë, EULEX-i synon të jetë neutral ndaj statusit, por në anën tjetër, EULEX-i mbështet institucionet e Kosovës. Duke iu referuar 'çështjeve teknike', siç reflektohet edhe në komunikimin e tij, diskursi i EULEX-it mund të përkufizohet si dualist dhe jo i balancuar. Dualizmi është pasojë e audiencës së larmishme që EULEX-i adreson dhe përpiqet t'i arrijë, të cilat kanë dallime në perspektivën mbi atë së çka është ose çfarë duhet të jetë EULEX-i. Me anë të kësaj, mesazhe adekuate janë dizajnuar që të parandalojnë përhapjen e informacioneve të rreme, për të ruajtur besueshmërinë apo të krijojnë pranimin e tyre. Përcaktimi i rolit të EULEX-it për këtë arsye është një proces i vazhdueshëm, duke iu përshtatur rrethanave, siç u tregua me marrjen e detyrave të reja dhe të ristrukturimit të tij operacional.

Nocionet - BE dhe EULEX - përdorur si sinonime sikur me qenë plotësisht në harmoni, qëllimisht duke sinjalizuar se nuk ka dallim në mes këtyre nocioneve. Megjithatë, për shkak të diversitetit të audiencës, është evidentuar një zbatueshmëri e 'standardeve të dyfishta' në diskursin dualist të EULEX-it. Kjo është si rezultat i ndarjes politike mes shteteve anëtare të BE-së që detyron EULEX-in të nënvlerësojë veprimet e veta dhe implikimet politike përkatëse. Pavarësisht natyrës së pretenduar të tij teknike, EULEX-i synon të rrisë kontributin e saj në lidhje me agjendën e BE-së në Kosovë, duke u përfshirë edhe në çështje politike si në veri, MIK, dialogut dhe liberalizimit të vizave.

Disa ndryshime në diskursin e EULEX-it janë evidentuar, një pasqyrim i ndryshimeve që kanë ndodhur në kontekstin në të cilin EULEX-i vepron dhe përshtatja e tij ndaj rrethanave (për shembull: ekspert, dialogu, etj.) Komunikimi i BE-EULEX karakterizohet nga përpjekja për ta ndërtuar reputacionin e tij si një aktor i fuqishëm ndërkombëtar që ka qenë nën ndikimin qëndrimeve të ndryshme politike rreth statusit të Kosovës dhe me atë vendosja e misionit. Si pasojë e kësaj, EULEX-i ka qenë i detyruar të ekzekutojë një komunikim reaktiv dhe mbrojtëse ndaj audiencës së tij të ndryshme duke nënvizuar aspektin teknik se sa rëndësinë së tij politike. Ky studim, trajtuar nga perspektiva e AKD, nxjerr në pah krijimin diskursiv të imazhit të BE-EULEX dhe relacionin e tij kundrejt audiencës së tij vendore dhe akterëve në kontekstin e Kosovës.

# Aneksi I

## Aneksi I: Frekuenca (shpeshtësia) e Terminologjisë Raporti i Programeve 2009-2012<sup>23</sup>

<b>Terminologjia</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>Theksimi (ose në kombinim me)</b>
<b>EULEX</b>	454	275	307	<i>Funksioni ekzekutiv i EULEX rrallë ose fare nuk përmendet</i>
<b>Plan</b>	214	95	103	<i>Plani i veprimit, planifikim, planifikim vjetor</i>
<b>Etnik</b>	138	10	16	<i>Shumë-etnike, pajtimi, komunitete etnike jo-shumicë</i>
<b>Bashkëpunim</b>	81	34	49	
<b>Strategji</b>	81	40	55	
<b>Vendore</b>	75	59	37	<i>CSO/NGO, gjyqtar, rregullore, institucione, autoritet publik</i>
<b>Efektive</b>	71	28	25	<i>Qasje, menaxhim i programit</i>
<b>Siguri</b>	64	45	27	<i>Nacional, special, publike</i>
<b>Evropian</b>	48	29	37	<i>Institucione, Misioni i sundimit te ligjit</i>
<b>Proaktive</b>	48	5	7	<i>Masa</i>
<b>Llogaridhënie</b>	44	8	13	<i>Transparenca, politika, përmirësimi</i>
<b>Sundimi i Ligjit</b>	44	43	87	
<b>Përbashkët (Joint)</b>	39	38	18	<i>Ekipi, menaxhimi, seminar, planifikim, aktivitete të përbashkëta</i>
<b>Politike</b>	37	5	11	<i>Rrethana, parti, interferenca, autoritet, përkatësi, nevojë</i>
<b>Strategjike</b>	29	21	29	<i>Kornizë strategjike, plan, objektiva,</i>
<b>Përbashkët (Common)</b>	24	5	10	<i>Sistem, shqetësim, problem, vetëdije e përbashkët, rrjet,</i>
<b>Qëndrueshmëri</b>	22	5	2	<i>OJQ, llogaridhënie, interferencë politike</i>
<b>Ekspert</b>	18	29	7	<i>Vetëm ekspertë të EULEX, kurrë në këmbim me vendorët</i>
<b>Homolog</b>	17	23	4	<i>Kosova, nacional, departamenti ligjor</i>
<b>Drejta të Njeriut</b>	16	9	6	<i>Të gjitha në kombinim me të drejtat e njeriut</i>
<b>Partneritet</b>	13	16	9	<i>Partner internacionale, institucione qeveritare, partneritet evropian</i>
<b>Pronësi</b>	6	3	1	<i>Lokal, nën pronësinë e autoriteteve të Kosovës</i>
<b>Rend publik</b>	6	4	5	<i>Sigurimin e rendit publik</i>
<b>Standard të BE</b>	5	None	3	<i>Me reference ndaj standardëve ndërkombëtare</i>
<b>Demokratike</b>	2	2	1	
<b>Praktika të mira të BE</b>	2	None	3	<i>Me reference ndaj praktika me të mira evropiane</i>
<b>Stabilitet</b>	1	2	None	<i>Stabilitet social</i>

<sup>23</sup> Viti 2012 nuk është i përfshirë për shkak të formatit të dokumentit.

# Bibliografia

## 1. Raporte

Council of the European Union (2008) Council Joint Action on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/Accountability/EULEX-PROGRAMME-REPORT-July-2009-neë.pdf> (retrieved on 12 June 2012)

EULEX Programme Report 2010 <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/tracking/EULEX%20Programme%20Report%202010%20.pdf> (retrieved on 12 June 2012)

EULEX Programme Report 2011 <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/tracking/EULEX%20Programme Report%202011.pdf> (retrieved on 13 June 2012)

EULEX Programme Report 2012 <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/Accountability/2012/EULEX Programme Report 2012-LoëQuality.pdf> (retrieved on 13 July 2012)

EULEX Lajm për shtyp (2009) <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/january-december-2009.php> (retrieved on 15 June 2012)

EULEX Lajm për shtyp (2010) <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/january-december-2010.php> (retrieved on 17 June 2012)

EULEX Lajm për shtyp (2011) <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/january-december-2011.php> (retrieved on 19 June 2012)

EULEX Lajm për shtyp (2012) <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/> (retrieved on 25 June 2012)

Forum for Security - KCSS Report: "Political Law Enforcement in Kosovo" [http://qkss.org/new/images/content/PDF/Zbati\\_mi\\_politik\\_i\\_ligjit\\_ANG.pdf](http://qkss.org/new/images/content/PDF/Zbati_mi_politik_i_ligjit_ANG.pdf) (retrieved on 5 July 2012)

Kallaba, P. & Ferati, V. (2012) "Mapping the UNSCR 1244 legacy in Post-Independence Kosovo: between contestation and

[eulex-kosovo.eu/en/info/docs/JointActionEULEX\\_EN.pdf](http://www.eulex-kosovo.eu/en/info/docs/JointActionEULEX_EN.pdf) (retrieved on 8 June 2012)

recognition" <http://qkss.org/new/images/content/PDF/English%20version%20-%20Mapping%20the%20UNSCR%201244%20legacy%20in%20post-independent%20Kosovo%20between%20contestation%20recognition.pdf> (retrieved on 12 July 2012)

Progress Report made in Kosovo (2011) <http://qkss.org/new/images/content/PDF/raporti-shabllon-design-english.pdf> p. 1-46 (retrieved on 2 June 2012)

Qehaja, F & Vrajolli, M. (2012) "Monitoring and Evaluating the Good Governance in the Security Sector" <http://qkss.org/new/images/content/PDF/Monitoring%20and%20Evaluating%20the%20Good%20Governance%20in%20the%20KSS.pdf> (retrieved on 12 July 2012)

## 2. Artikuj:

Grabbe, H. (1999) A Partnership for Accession? The Implications of EU Conditionality for the Central and East European Applicants [http://www.esiweb.org/enlargement/wp-content/uploads/2010/01/grabbe\\_conditionality\\_99.pdf](http://www.esiweb.org/enlargement/wp-content/uploads/2010/01/grabbe_conditionality_99.pdf) p.1-31 (retrieved on 25 July 2012)

Greïçevci, L. EU Actorness in International Affairs: The Case of EULEX Mission in Kosovo [http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2009\\_2014/documents/afet/dv/201/201205/20120530\\_article\\_eulex\\_1\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2009_2014/documents/afet/dv/201/201205/20120530_article_eulex_1_en.pdf) p.1-22 (retrieved on 12 June 2012)

Muharremi, R (2010) The European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEX) from the Perspective of Kosovo Constitutional Law [http://www.zaoerv.de/70\\_2010/70\\_2010\\_2\\_a\\_35\\_7\\_380.pdf](http://www.zaoerv.de/70_2010/70_2010_2_a_35_7_380.pdf) p.1-24 (retrieved on 2 July 2012)

Peters, S. (2010) EU Diplomacy Papers. Strategic Communication for Crisis Management Operations of International Organisations: ISAF Afghanistan and EULEX Kosovo <http://aei.pitt.edu/12358/> p. 1-34 (retrieved on 7 June 2012)

Rasmussen, S.B. (2009) DISCOURSE ANALYSIS OF EU PUBLIC DIPLOMACY: MESSAGES AND PRACTICES [http://www.clingendael.nl/publications/2009/20090700\\_cdsp\\_discussion\\_paper\\_115\\_Rasmussen.pdf](http://www.clingendael.nl/publications/2009/20090700_cdsp_discussion_paper_115_Rasmussen.pdf) p.1-41 (retrieved on 1 June 2012)

Tomic, N. (2011) Discourse and CFSP/PPSM Policy-Making: Conceptual and Methodological Concerns [https://docs.google.com/viewer?a=v&q=cache:axGNZ4NZvxgJ:ëëë.uacesstudentforum.org/pdf/neë\\_frontiers\\_papers/tomic.pdf+eulex+discourse+analysis&hl=en&pid=bl&srcid=ADGEEsGCIpqQy4Qd\\_j5deLv0BhIh9atgN4k0No2IBhdMP-gdgC5mKcRnaToV-JsJUnNedfhuskDZ-zBu1DM32mQëA8Z4nëc6LcKQXHOCZH30x-YR0qEzdZS9-a3bPWaXhfv8WJzxuyV&sig=AHIEtbRMAGm7bsOëIjafeiujuH5Y0UZKjQ](https://docs.google.com/viewer?a=v&q=cache:axGNZ4NZvxgJ:ëëë.uacesstudentforum.org/pdf/neë_frontiers_papers/tomic.pdf+eulex+discourse+analysis&hl=en&pid=bl&srcid=ADGEEsGCIpqQy4Qd_j5deLv0BhIh9atgN4k0No2IBhdMP-gdgC5mKcRnaToV-JsJUnNedfhuskDZ-zBu1DM32mQëA8Z4nëc6LcKQXHOCZH30x-YR0qEzdZS9-a3bPWaXhfv8WJzxuyV&sig=AHIEtbRMAGm7bsOëIjafeiujuH5Y0UZKjQ) p. 1-26 (Retrieved on 15 June 2012)

The study of discourse <http://www.discourses.org/OldArticles/The%20study%20of%20discourse.pdf> p. 1-14 (retrieved on 8 June 2012)

Wodak, R. (2008) Critical Discourse Analysis: History, Agenda, Theory, and Methodology; available at: [http://www.uk.sagepub.com/upm-data/24615\\_01\\_Wodak\\_Ch\\_01.pdf](http://www.uk.sagepub.com/upm-data/24615_01_Wodak_Ch_01.pdf) p. 1-31 (retrieved on 5 June 2012)

Sheyholislami, J. (2001) Critical Discourse Analysis. <http://http-server.carleton.ca/~jshehol/articles/ëhat%20is%20AKD.pdf> p. 1-15 (retrieved on 2 June 2012)

Van Dijk, T. (1998) Critical Discourse Analysis <http://www.discourses.org/OldArticles/Critical%20discourse%20analysis.pdf> p.1-20 (retrieved on 25 May 2012)

### 3. Burime tjera nga interneti:

<http://www.eurotribune.eu/index.default.php/?p=26828>

<http://www.balkaninsight.com/en/article/eulex-fights-back-to-critics>

<http://www.evropaelire.org/content/article/24278666.html>